




MODELI 3D I QYTETIT TË SARANDËS
PËRFTUAR NGA TËKNOLOGJIA UAV

Përdorimi i shërbimeve satelitore për evidentimin e dëmeve nga përmbytjet

Në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), ASIG ka kryer analizimin e ndryshimeve të ndodhura nga përmbytjet, të cilat prekën zonat: “Bashkia Durrës”, “Shëngjin-Gjadër”, “Spiten, Lezhë”, “Velipojë-Bahçallëk-Vau i Dejës, Shkodër”, “Novoselë, Vlorë”, “Kozar, Kuçovë”.

Me anë të përdorimit të teknologjisë së avancuar Remote Sensing, u ndërtuan hartat tematike të zonave të prekura nga përmbytjet, të cilat paraqesin një analizë krahasuese të imazheve satelitore të marra para ngjarjes (maj-shtator 2025) dhe pas përmbytjes (janar 2026), me qëllim evidentimin dhe vlerësimin e ndikimit në infrastrukturën rrugore dhe ndërtesat brenda zonës së interesit.

Analiza ofron një pasqyrë të ndryshimeve gjeohapësinore të shkaktuara nga përmbytja, duke mundësuar vlerësimin e dëmeve, monitorimin e riskut dhe planifikimin e ndërhyrjeve dhe masave parandaluese.





Harta tematike e përmbytjes së zonës
“Velipojë-Bahçallëk-Vau i Dejës, Shkodër”

Publikohet informacion gjeohapësinor për temën “Ortoimazheria”

ASIG, në rolin e autoritetit publik përgjegjës për temën “Ortoimazheria”, ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresën “Ortofoto 1976–1986 (1:25000)”. Realizimi i kësaj ortofotoje është përfutur nga fotografite ajrore analoge, historike të realizuara gjatë periudhës 1976–1986 nga Instituti Topografik i Ushtrisë (ITU), të cilat janë përdorur ndër vite për prodhimin e hartave topografike në këtë shkallë.

Ky informacion mund të përdoret për analiza gjeohapësinore mbi përdorimin e tokës, zhvillimin urban, infrastrukturën, ndryshimet mjedisore, si dhe proceset e lidhura me pronat dhe planifikimin. Të dhënat janë konform standardit të miratuar me VKM-në nr. 397, datë 19.06.2019, për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Ortoimazheria”.



Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar


Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare dhe urbane me teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360°, ASIG ka realizuar fotografimin e rrugëve urbane të qytetit të Sarandës, me një mbulim prej 119 km. Të dhënat vizuale janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar duke ofruar një panoramë të detajuar të infrastrukturës rrugore në këtë qytet.

Ky informacion përbën një mjet të rëndësishëm mbështetës për planifikimin e vazhdueshëm territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë Urbane – Sarandë

Zgjerimi i Hartës Bazë - Qyteti Ersekë



Qyteti Ersekë

ASIG në cilësinë e autoritetit publik përgjegjës për temën “Harta Bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale të qytetit të Ersekës. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rievimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rievuar prej 4.7 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rievime fotogrametrike 3D arrin në 180.

Shërbime dhe të dhëna gjeohapësinore me pagesë nga ASIG

Në muajin janar 2026, ASIG ka nisur zbatimin e ofrimit me pagesë të një pjese të shërbimeve dhe të dhënave gjeohapësinore, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Tarifimi bazohet në VKM- në nr. 336, datë 19.06.2025, e cila përcakton listën e të dhënave dhe shërbimeve që i nënshtrohen tarifimit, si edhe masën përkatëse të tarifës.

Shërbimet dhe të dhënat e parashikuara ofrohen me pagesë për individë dhe subjekte private, në funksion të realizimit të punimeve gjeodezike, inxhinierike dhe shkencore. Për më shumë informacion, vizitoni [linkun](#).

Shërbime dhe të dhëna gjeohapësinore me pagesë



KRGJSH



ALBCORS



Fotogrametri
Hartografi



Remote
Sensing

BOTA E GJEOINFORMACIONIT

Platforma "Digital Space Ecosystem" që lidh komunitetin hapësinor evropian

Platforma "Digital Space Ecosystem", e zhvilluar nga Komisioni Evropian, ofron një hapësirë të përbashkët online ku aktorët e sektorit hapësinor evropian lidhen, shkëmbejnë informacione dhe identifikojnë mundësi bashkëpunimi. Ajo bashkon autoritete publike, agjenci, industri, organizata kërkimore, universitete dhe profesionistë, duke mundësuar "hubs" tematikë, profile individësh e organizatash, si edhe një "marketplace" me katalogë produktesh/shërbimesh, ofertë-kërkesa dhe mjete "matchmaking". Gjithashtu, aty gjendet informacion mbi financime, projekte dhe evente, me synim rritjen e vizibilitetit të aktorëve dhe iniciativave, si dhe lehtësimin e krijimit të partneriteteve dhe bashkëpunimeve në të gjithë ekosistemin hapësinor evropian.

ESA teston kapacitetet e Sentinel-2 për vëzhgim gjatë natës

Agjencia Evropiane e Hapësirës (European Space Agency - ESA) po përdor satelitin Copernicus Sentinel-2A, pas më shumë se 10 vitesh në orbitë, për prova duke e aktivizuar gjatë kalimeve mbi zonat e Tokës ku është natë, për të vlerësuar performancën e tij në errësirë. Rezultatet janë premtuese, duke kapur flakërime gazi, zjarre dhe anije peshkimi edhe gjatë natës. Këto prova po mbështesin zhvillimin e misionit Sentinel-2 Next Generation, që synon imazhe me rezolucion më të lartë dhe vëzhgim të kufizuar natën në zona të caktuara.

AKTIVITETE NË VIJIM

ICBDIG - 26

Nga data 10-11 shkurt 2026, në Berlin të Gjermanisë, do të zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare mbi Integrimin e Big Data me GIS (ICBDIG), një aktivitet i fokusuar në integrimin e të dhënave të mëdha me GIS. Konferenca përfshin sesione teknike dhe diskutime mbi analiza gjeohapësinore, vizualizim dhe menaxhim të të dhënave, duke mbështetur zhvillimin e aplikimeve praktike dhe inovative në këtë fushë.

10 - 11 Shkurt 2026

ICCG 2026

Më 18 mars 2026, në Barcelonë, të Spanjës, do të zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare për Kartografinë dhe GIS (ICCG). Ky aktivitet synon të mbledhë studiues, profesionistë dhe ekspertë nga vende të ndryshme për të shkëmbyer ide, përvoja dhe rezultate kërkimore në fushën e kartografisë dhe GIS-it duke ofruar mundësi për ndërtimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe forcimin e lidhjeve kërkimore dhe profesionale.

18 Mars 2026

Munich Space Week

Nga data 23-27 mars 2026, në Mynih të Gjermanisë, do të zhvillohet Munich Space Week 2026, një aktivitet që bashkon Samitin e Hapësirës së Re dhe Samitin e Navigimit Satelitor. Ky event fokusohet në hapësirën dhe navigimin satelitor duke mbledhur përfaqësues të industrisë, akademisë, institucioneve dhe startup-eve për të nxitur bashkëpunimin e vazhdueshëm, inovacionin dhe shkëmbimin e njohurive.

23 - 27 Mars 2026

www.asig.gov.al

www.geoportal.asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;

Telefon: +355 (0)42 223 762;

E-mail: info@asig.gov.al